

DITURIA

E PËRKOHËSHMË SHQIPËTARE

Del një herë në muaj

DREJTONJËS: LUMO SKENDO

MBAN:

Luftët e Cesarit dhe Pompe në Shqipëri — Tërmeti — Aktiviteti i Shqipëtarëve në Rumani — Tribunë gramatike dhe gjuhësije — Bibliografi shqipëtare.

TIRANË

LIBRARIJA LUMO SKENDO

1927

I dashur Këndonjës,

Kur vendosa të botonj DITURINË desha më parë të siguronj jetën e saj materiale; dhe, që të kupëtonj sa pajtimtarë do të kemj, pra sa të holla do të më vijnë, dërgova grishimin nek atá zotërinj që e kupëtonja se do të interesohen ne botimi i një reviste së tillë. Grishimet na u-kthyenë të nënëshkruarë prej miqvet t'anë.

Kur pashë se numuri i nënëshkrimtarëve ishte i mjaftë, fillova shtypjen e së përkohëshmesë. Sot jemi ne numuri i katrët.

Mjerisht, prej atyreve që me dhanë fjalën dhe nënëshkrimin, më e shuma ka neglizhuarë të na dërgojë pajtimin.

Gjyshërit t'anë e kishin zakon të mbajnë *besën* vetëm me një fjalë. Kujtonja se një fjalë e dhënë me nënëshkrim, do të ishte një besë më e fortë.

Në qoftë se vazhdon mos kujdesja, kam frikë se DITURIJA do të mbetetë pa dalë. Më vjen keq të parashoh ketë fatkeqësi, dhe më pëlqen të besonj se vonimi i atyneve që na dërguan nënëshkrimin e tyre, do të marrë një funt.

Si do që të jetë po bënj edhe një thirje të mrame: Ata që duanë të pagojnë pajtimin e tyre le të na e dërgojnë. Ata që janë penduarë dhe s'duanë të pagojnë, le të na kthejnë numuret 1 dhe 2 të Diturisë. — Këtë lutje të fundit po e bënj me insistencë, se, në mos më kthefshin këtë numure, nukë munt të bënj as pajtimtarë të rinj.

Më duket se kam të drejtë të bënj këtë lutje dhe shpresonj, të dashurë këndonjës, që nukë do të m'a refuzoni.

DITURIJA

